



БОРБА  
ПРОТИВ  
ТОРТУРА И  
НЕХУМАН  
ТРЕТМАН

# RAPORT PËR GJENDJEN DHE KUSHTET NË SPITALET PSIKIATRIKE DHE INSTITUCIONET E MBROJTJES SOCIALE

në bazë të vizitave në  
ISHP Spitali Psikiatrik Shkup,  
ISHP Spitali Psikiatrik Negorci,  
ISHP Spitali Psikiatrik Demir Hisar,  
Institucioni Publik Special në Demir Kapi  
(tetor - nëntor 2023)

SHKUP, 2023



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Evropian



KOMITETI I  
HELSINKIT PËR  
TË DREJTAT E  
NJERIUT



МЗМП

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut  
i përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

**Autorë:**

Tona Kareva Taleska

**Bashkautore:**

Dushica Nofitoska

**Redaktore:**

Liljana Ignjatova

**Lektore:**

Violeta Tançeva-Zlateva

**Përkthimi në shqip:**

Shenasi Jaji

**Viti i botimit:**

2023

**Vendi i botimit:**

Shkup

**Numri i faqeve:**

43

**Dizajni grafik:**

Masiva Creative Agency

**Tirazhi:**

100 ekzemplarë



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>ORARI I VIZITAVE .....</b>	<b>6</b>
<b>RRETH PROJEKTIT .....</b>	<b>7</b>
<b>METODOLOGJIA E VIZITAVE .....</b>	<b>8</b>
<b>ISHP SPITALI PSIKIATRIK SHKUP .....</b>	<b>10</b>
Rekomandime .....	16
<b>ISHP SPITALI PSIKIATRIK NEGORCI .....</b>	<b>21</b>
Rekomandime .....	26
<b>ISHP SPITALI PSIKIATRIK DEMIR HISAR .....</b>	<b>29</b>
Rekomandime .....	34
<b>INSTITUCIONI PUBLIK SPECIAL NË DEMIR KAPI .....</b>	<b>38</b>
Rekomandime .....	42

## HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Lufta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor”, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Për qëllime të projektit është lidhur memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Në periudhën nga tetori deri në nëntor të vitit 2023 janë realizuar 4 vizita, përkatësisht - ISHP Spitali Psikiatrik “Shkup”, ISHP Spitali Psikiatrik Negorci, ISHP Spitali Psikiatrik Demir Hisar dhe Institucioni Special Demir Kapi. Këto institucione janë përzgjedhur sepse hospitalizojnë persona të ndaluar dhe trajtuar në mënyrë të pavullnetshme, madje kanë edhe reparte gjyqësore ku mbahen dhe trajtohen pacientët me masa sigurie të përcaktuara nga gjykata, pra persona të privuar nga liria.

Gjetjet në këtë raport bazohen në vizitat e kryera nga ekipi i monitorimit, i cili gjatë vizitave ka inspektuar ambientet e institucioneve, ka zhvilluar një bisedë me drejtuesit e institucioneve, si dhe me psikiatër të punësuar, mjekë, psikologë, punonjës socialë, infermierë/e, kujdestarë, ndihmësmjekë, pacientë etj.

Në përputhje me nenin 7 të Konventës Evropiane për parandalimin e torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve çnjerëzore ose degraduese, dhe për të parandaluar një trajtim dhe ndëshkim të tillë, është e nevojshme të monitorohen të gjitha institucionet ku ka persona të privuar nga liria, përfshirë spitalet psikiatrike dhe institucionet e mbrojtjes sociale.

Në gjetjet dhe rekomandimet e fundit të Komitetit për Parandalimin e Torturës gjatë vizitës në spitalet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019, inkurajohen autoritetet përkatëse që të ofrojnë kujdes adekuat në komunitet për pacientët me çrregullime kronike mendore të cilët nuk kanë nevojë për trajtim dhe kujdes spitalor, por për shkak të mungesës së kujdesit të duhur në komunitet, ata qëndrojnë në spital për vite me radhë. Komiteti vëren gjithashtu se: në disa reparte psikiatrike, tualetet, banjat dhe higjiena ishin në nivel shumë të ulët; disa pacientë nuk ishin në gjendje të dilnin jashtë për javë apo edhe muaj; gjendja e personelit ishte e pakënaqshme; ka pasur trajtim të pamjaftueshëm psiko-social; kufizimi mekanik është bërë edhe me zinxhirë metalikë, pa mbikëqyrje të vazhdueshme dhe para pacientëve të tjerë; shumë “pacientë të ndaluar

vullnetarisht” u privuan nga liria, pa përfituar nga masat mbrojtëse të parashikuara në ligj për pacientët e ndaluar në mënyrë të pavullnetshme, kurse gjykata nuk ka marrë vendim as për muaj të tërë për pacientët e strehuar me forcë, dhe prej vitesh nuk është bërë as ekzaminim vjetor i pacientëve mjeko-ligjorë nga ana e gjyqtarëve. Diçka e rëndësishme të përmendet është se legjislacioni përkatës i shëndetit mendor nuk parashikon ndonjë procedurë për trajtimin e pavullnetshëm të pacientëve psikiatrikë, dhe në praktikë shpesh nuk është bërë asnjë dallim midis vendosjes së pavullnetshme dhe trajtimit të pavullnetshëm të një pacienti.

Gjatë së njëjtës vizitë, dhe në lidhje me Institucionin e posaçëm për personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin intelektual në Demir Kapi, Komiteti shprehu shqetësimin për kushtet materiale të pavijoneve për personat me aftësi dhe pengesa më të rënda intelektuale dhe pamundësinë e tyre për të dalë jashtë për muaj të tërë, kurse kujdesin dentar e vlerësuan si thuajse inekzistent. Gjithashtu, Komiteti rekomandoi që autoritetet përkatëse të fuqizojnë masat e mbrojtjes ligjore duke u dhënë përfituesve të drejtën efektive për të nisur një procedurë për të pasur ligjshmërinë e akomodimit të tyre.

Për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës në këto institucione (spitale psikiatrike dhe institucione të mbrojtjes sociale) ku ka persona të privuar nga liria, ekipi i monitorimit, para vizitës, është njohur me metodologjinë e vlerësimit të institucioneve psikiatrike dhe të mbrojtjes sociale dhe ka bërë një analizë të legjislacionit ekzistues, veçanërisht Ligjit për Shëndetin Mendor, Neni 16 dhe Neni 20, paragrafi 7; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve, Neni. 11–32 dhe Neni 44, Ligji për procedurën Jashtëkontestimore, Neni 58–68; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, neni 58; Ligji i Procedurës Penale, Neni 248; Kodi Penal, Neni 63 dhe Neni 149; Rregullorja për hapësirën, pajisjet dhe personelin e nevojshëm profesional për themelimin, fillimin e punës dhe kryerjen e veprimtarive shëndetësore në objektin shëndetësor (neni 35-42); Ligji për Mbrojtjen Sociale, Neni 94, Neni 95, Neni 97, Neni 261–263; Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 104 dhe rregulloret në spitale dhe institucione për mbrojtje sociale (statuti i institucionit) dhe të tjera.

# ORARI I VIZITAVE

DATA	INSTITUCIONI	EKIPI
16.10.2023	<b>ISHP Spitali Psikiatrik Shkup</b>	<b>Uranija Pirovska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Tona Kareva Taleska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Liljana Ignjatova</b> psikiatër <b>Dime Gjorçeski</b> avokat <b>Dushica Nofitoska</b> Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
30.10.2023	<b>ISHP Spitali Psikiatrik Negorci</b>	<b>Tona Kareva Taleska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Aleksandra Trajanovska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Liljana Ignjatova</b> psikiatër <b>Dushica Nofitoska</b> Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
02.11.2023	<b>ISHP Spitali Psikiatrik Demir Hisar</b>	<b>Tona Kareva Taleska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Liljana Ignjatova</b> psikiatër <b>Dushica Nofitoska</b> Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
06.11.2023	<b>Institucioni Publik Special në Demir Kapi</b>	<b>Tona Kareva Taleska</b> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut <b>Liljana Ignjatova</b> psikiatër <b>Dushica Nofitoska</b> Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj

## RRETH PROJEKTIT

Projekti “Lufta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor” zbatohet në partneritet me Shoqatën e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, dhe financohet nga Bashkimi Evropian. Qëllimi kryesor është eliminimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet, institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe spitalet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Qëllimet specifike janë:

- (1) Të forcohen personat e dënuar, personat e privuar nga liria dhe pacientët në institucionet psikiatrike për të raportuar dhe kërkuar kompensim për torturën e pësuar dhe trajtimin çnjerëzor;
- (2) Të rritet përgjegjësia e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor; dhe
- (3) Të forcohen kapacitetet e institucioneve për njohjen dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Grupet e synuara në kuadër të projektit janë personat e dënuar, personat e privuar nga liria, fëmijët në konflikt me ligjin dhe pacientët në institucionet psikiatrike.

Në kuadër të projektit janë planifikuar disa aktivitete, përkatësisht: ofrimi i ndihmës juridike, përgatitja e materialeve edukative për personat e vendosur në institucionet psikiatrike, organizimi i sesioneve informuese për të drejtat e personave të dënuar dhe personave të vendosur në institucionet psikiatrike, përfaqësimi strategjik, monitorimi i institucioneve ndëshkimore-korrektuese, institucioneve korrektuese dhe psikiatrike, monitorimi i punës së prokurorisë publike për ndjekjen e krimeve të kryera nga policia dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve, seanca edukative për avokatë dhe punonjës socialë në institucionet ndëshkimore-korrektuese, mbështetje për miratimin e akteve nënligjore.

## METODOLOGJIA E VIZITAVE

Është zhvilluar metodologji për nevojën e monitorimit në spitalet psikiatrike dhe institucionet e mirëqenies sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila është në përputhje me metodologjinë e Komitetit për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese dhe Trajtimi ose Ndëshkimi Çnjerëzor ose Degradues (KPT – Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, CPT).

Sipas kësaj metodologjie, gjatë vizitave delegacioni monitorues duhet të shqyrtojë dhe analizojë dokumentacionin në dispozicion nëpër këto institucione. Gjatë vizitës, delegacioni duhet të kryejë vëzhgime, si dhe intervista/ose grupe të synuara me zyrtarë, personel mjekësor dhe pacientë/përdorues. Intervistat me pacientët/përfituesit duhet të jenë konfidenciale dhe të kryhen pa praninë e personelit të punësuar.

Një vlerësim gjithëpërfshirës i një spitali psikiatrik përfshin: një analizë të bazës ligjore në lidhje me shërbimet e shëndetit mendor; intervista fillestare me drejtorin; vizita në të gjitha ambientet e institucionit; rishikimi i të dhënave mjekësore dhe dokumentacionit tjetër; intervistat e pacientëve; intervistat me stafin dhe, në fund, biseda përsëri me drejtorin nëse nevojiten informacione të mëtejshme. Pyetjet që duhet t'i drejtohen menaxhmentit të spitalit kanë të bëjnë me: kapacitetin e objektit; kategori të ndryshme pacientësh; numri i pacientëve të pranuar në mënyrë të pavullnetshme; struktura spitalore; stafi; mbështetja e jashtme; çështjet financiare; statistikat mjekësore; trajtimet speciale; dokumentacion mjekësor; planet për zhvillimin e ardhshëm; udhëzimet dhe protokollat; trajnimin dhe mbikëqyrjen e stafit. Pyetjet që duhet të adresohen në nivelin e departamentit kanë të bëjnë me: procedurat e pranimit; akomodimi; mënyra e vëzhgimit; aktivitetet e përditshme; prania e personelit mjekësor dhe paramjekësor; planet e trajtimit dhe puna ekipore; barna; trajtime psikoterapeutike dhe ndërhyrje psiko-sociale; dhuna.

Rishikimi i dokumenteve dhe intervistat me pacientët dhe stafin kryhen për çështjet e mëposhtme: përdorimi i kufizimeve dhe izolimi; ecja dhe ushtrimet në natyrë; pacientët nën regjime të veçanta; kufizimet në posedim dhe kërkime; terapi elektrokonvulsive; kategoritë e cënueshme; kontakte me botën e jashtme; parandalimi i vetëvrasjeve; kërkime



biomjekësore. Nëpërmjet vëzhgimit dhe intervistave me stafin dhe pacientët vlerësohen kushtet materiale: kushtet e jetesës në departamente të ndryshme; veshje; ushqim; tualete dhe banjo. Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe intervistave me stafin dhe pacientët, vlerësohen çështjet ligjore: statusi ligjor i pacientëve; ndalimi i pavullnetshëm; pëlqimi/dakordimi për trajtim; informacion mbi të drejtat dhe aksesin në ndihmë juridike; procedura e ankesave; vizita nga organet e jashtme monitoruese.

Gjatë vlerësimit të institucioneve për mbrojtje sociale, mblidhen informacione të përgjithshme për kapacitetin e institucionit; personelin dhe mbështetjen e jashtme; të dhënat e mbidhunës; kushtet e jetesës; mbrojtjen e shëndetit; mjetet e kufizimit; masat mbrojtëse në kontekstin e vendosjes së pavullnetshme; trajtimi i detyruar; masat mbrojtëse për personat të cilëve u është hequr aftësia afariste dhe çështje të tjera, si kontakti me botën e jashtme, mundësia e ankimimit etj.

## ISHP SPITALI PSIKIATRIK SHKUP

Vizita në ISHP Spitalin Psikiatrik Shkup filloi me një bisedë me drejtorin e institucionit. Kapaciteti total i spitalit është 323 shtretër, pra për 323 pacientë. Gjendja aktuale në momentin e vizitës ishte 319 pacientë të vendosur në institucion.

Në spital janë gjithsej 12 reparte dhe numri i pacientëve të akomoduar me vendime gjyqësore është 83 pacientë, të cilët janë të akomoduar në disa reparte, jo vetëm në repartin e gjykatës. Por nuk morëm shpjegim se pse dhe sipas cilave kritere vendosen në reparte/departamente të ndryshme, përveç përdoruesve femra, të cilat për shkak të mungesës së repartit/departamentit të gjykatës për gratë, vendosen në reparte/departamente të tjera.

Në bashkëbisedimin me përfaqësuesit e spitalit, kuptuam se ka problem në menaxhimin e pacientëve si të paraburgosur vullnetarisht dhe në mënyrë të pavullnetshme, pra pothuajse të gjithë pacientët, edhe pse janë të ndaluar në mënyrë të pavullnetshme, menaxhohen si të ndaluar vullnetarisht. Në momentin e vizitës ishin vetëm 2 pacientë të ndaluar në mënyrë të pavullnetshme. Gjithashtu, personat që akomodohen vullnetarisht, d.m.th. menaxhohen si të akomoduar vullnetarisht dhe duan të largohen nga spitali, nëse ka arsye mjekësore për të cilat lirimi i tyre nuk është i përshtatshëm, ndalohen në spital pa e shndërruar ndalimin në të pavullnetshëm dhe duke njoftuar gjykatën, pra pa përfituar nga masat mbrojtëse të parashikuara në ligj për pacientët e ndaluar në mënyrë të pavullnetshme, duke i hequr kështu lirinë. Kjo praktikë ka kontribuar në një numër të madh të pacientëve që qëndrojnë në spital për vite me radhë kur nuk ka nevojë për trajtim në spital, sepse askush nuk dëshiron ose nuk ka njeri që të kujdeset për ta në komunitet. Një pjesë e madhe e këtyre pacientëve janë zhvilluar sindromën e hospitalizimit (një formë e veçantë sjelljeje pas një shtrimi të gjatë), ndaj dalja e tyre nga spitali pas 10, 20, apo edhe 30 vitesh të kaluar në spital psikiatrik është një sfidë serioze.

Nga një pacient është marrë informacion se ai ishte bindur të firmoste se ishte dakord për mjekim vullnetar, sepse ishte më mirë për të, edhe pse e sollën me dhunë, por kur u lirua në shtëpi, ai u kthye menjëherë në spital nga ana e familjarëve. Stafi i spitalit raporton se familjet ndonjëherë mësohen se mund të raportojnë dhunën në familje, si një mënyrë për t'i

çuar pacientët në një spital mendor, duke abuzuar kështu me masat për mbrojtje për shkak të dhunës në familje.

Problemi më i madh që ishte theksuar nga punonjësit e spitalit është numri i madh i pacientëve që nuk kanë nevojë për trajtim spitalor, respektivisht që mund të jetojnë me mbështetje, por për shkak të interesit të pamjaftueshëm për kujdes nga ana e familjeve dhe mungesës së kujdesit dhe mbështetjes së gjerë në komunitet nga institucionet, janë lënë në spital. Në këtë mënyrë bëhet e vështirë përkujdesja për ata pacientë që kanë një indikacion real për trajtimin spitalor, duke pasur parasysh numrin e madh të pacientëve dhe numrin e vogël të stafit profesional.

Çdo repart/departament ka një infermiere, një infermiere departamenti, një paramedik dhe një mjek, dhe disa nga departamentet kanë edhe një psikolog dhe një punonjës social që ofrojnë shërbime për më shumë persona, pra për të gjitha departamentet e spitalit. Pas orës 14:00, kur mbaron turni i parë, në çdo departament ka vetëm një infermiere dhe një ndihmës mjek. Një problem me të cilin përballet spitali është mungesa e stafit, përfshirë stafin mjekësor profesional; Në pjesën spitalore të spitalit janë gjithsej 13 psikiatër, që është i vogël në raport me numrin e pacientëve, dhe sipas orarit janë në shërbim dy psikiatër për turn, gjithsej 17 psikiatër nga spitali dhe nga ekstrasptiali. Kemi marrë informacione se buxheti vjetor i spitalit është 256 milionë denarë, ndërsa shuma për ditë spitalore për pacient është 1400 denarë, të cilat nuk janë mjete të mjaftueshme. Në momentin e vizitës ishte duke u rinovuar reparti i tretë i grave dhe klinika e pritjes, gjegjësisht dhomat e kujdesit të mjekut dhe nuk kanë ndonjë plan tjetër për rikonstruksion në të ardhmen. Na u theksua se kohët e fundit nuk kanë pasur asnjë trajnim, përveç trajnimit bazë për punësim. Gjithashtu, ata nuk kanë një plan trajnimi. Nuk ka as protokolle për parandalimin e vetëvrasjeve. Ekziston një protokoll për fiksimin - kufizimin e një pacienti të shqetësuar.

Gjatë vizitës u informuam se ka dhunë mes pacientëve dhe se nevojitet edukim i përshtatur për pacientët. Gjithashtu, u informuam se pacientët e dhunshëm, veçanërisht ata nga departamenti i gjykatës, janë të ndarë nga pacientët e tjerë të gjykatës në një objekt të veçantë. Sa i përket pacientëve të departamentit të drejtësisë të cilët janë të ndarë, duhet theksuar se gjatë vizitës derën e objektit na e kanë hapur vetë pacientët dhe sigurimi është paraqitur më vonë. Gjithashtu, në lidhje me këta pacientë dhe gjatë bisedës me ta, lind pyetja nëse të gjithë duhet të vendosen vërtet në këtë ambient

duke marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore, mënyrën e komunikimit dhe aftësinë për të arsyetuar, d.m.th. të jetë i nevojshëm rishikimi i masave të sigurisë që kanë marrë.

Për sa i përket përdorimit të kapëseve dhe izolimit, pra fiksimit, nuk ka dhoma të veçanta me pasqyrë të veçantë për pacientët fiks në të gjitha departamentet. Na thanë se pacientët nuk ndihmojnë me fiksimin dhe se fiksimi bëhet privatisht, në rastet kur është e nevojshme, por në pavijonin e pacientëve meshkuj të dhunshëm (pavioni i dytë i meshkujve) morëm informacion se fiksimi mund të ndodhë edhe para pacientëve të tjerë. Ekziston një protokoll për aplikimin e kapëseve. Personat mbi të cilët përdoren kapëse dhe izolues monitorohen shumicën e kohës çdo 15 minuta dhe për shkak të mungesës së personelit nuk ekziston mundësia e pranisë fizike dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të pacientëve ndaj të cilëve zbatohen këto masa. Nuk ka tualete në dhomat ku aplikohen këto masa. Të dhënat për këto procedura regjistrohen në fletore.

Sa i përket shëtitjeve jashtë, na u tha se jo të gjithë pacientët nxirren jashtë, veçanërisht ata që janë të palëvizshëm ose kanë vështirësi në lëvizje, por shumica e pacientëve nxirren jashtë për shëtitje. Ushtrimet në natyrë me pacientë nuk praktikohen.

Vizitat e pacientëve kryhen rregullisht. Kutitë e ankesave janë të disponueshme në të gjitha departamentet dhe mund të përdoren nga pacientët. Sa i përket veshjeve, një pjesë e pacientëve i kanë të tyret, por ka nga ata që nuk kanë rroba, ndaj punonjësit socialë mbledhin donacione, por ka edhe nga ata që janë gjithmonë me pizhame.

Të gjithë pacientët lahen rregullisht, të paktën një herë në javë dhe më shpesh nëse është e nevojshme. Ekzaminimet laboratorike rutinë bëhen dy herë në vit dhe më shpesh nëse është e nevojshme. Tek pacientët nuk ka objekte të mprehta. Stafii (sipas gjinisë përkatëse) kryen kontroll gjatë pranimit të pacientëve.

Pacientët nuk kishin dollapë që mund të mbylleshin, kështu që ndodh që disa gjëra t'u zhduken, por gjërat me vlerë zakonisht mbaheshin dhe ruheshin nga një punonjës social.

Ushqimi në spital gatuhet dhe sigurohet nga ana e spitalit, por familjet gjithashtu mund t'u dorëzojnë ushqim shtesë pacientëve.

Nuk ka praktikë dhe nuk ka ndodhur në spital që drejtori të marrë ankesa nga pacientët.

## Gjendja e reparteve/departamenteve

Në departamentin e dytë të meshkujve higjiena ishte në nivele të ulëta dhe pacientët pinë duhan kudo në departament, kështu që aroma është e keqe. Gjithashtu ka një tualet për të gjithë dhe kushtet materiale të tualetit janë katastrofike. Çdo dhomë strehon 8 pacientë. Ka një dhomë të veçantë mensash, ku higjiena dhe kushtet në të ishin të kënaqshme. Në këtë pavijon ka një dhomë të veçantë fiksime me katër krevate me dritare, e cila është ngjitur me zyrën e personelit, por kushtet e repartit janë të tilla që stafi nuk mund të sigurohet gjithmonë që kjo të mos ndodhë përpara një pacienti tjetër. Disa nga dhomat nuk kanë dyer, ndaj kanë vendosur batanije për privatësi. Në këtë repart janë akomoduar 14 pacientë me vendime gjyqësore. Ky repart është për pacientë të dhunshëm, ndaj nuk mungojnë shpesh rastet e dhunës mes pacientëve, por edhe ndaj personelit.

Reparti akut, repartit i parë i përzier dhe repartit i dytë i femrave ndodhen në të njëjtën hapësirë. Repartit i dytë i grave ka një kapacitet shumë të vogël dhe përbëhet nga vetëm 4 dhoma. Në këto departamente higjiena ishte në nivel të kënaqshëm. Pacientët vendosen në një dhomë me 2 ose 3 persona, por ekziston një praktikë e shpërndarjes së dobët të pacientëve sipas reparteve. Konkretisht, kur nuk ka vend, pacientët akomodohen në çdo departament. Në këtë repart, tualetet e dhomave janë në gjendje katastrofike, megjithëse vetë hapësira është relativisht e re dhe e rinovuar. Është vërejtur se disa nga pacientët lajnë duart dhe i thanë rrobat e tyre në dhoma dhe tualete. Pacientët u ankuan se ishin të ftohtë dhe se ngrohja e repartit ishte e pamjaftueshme.

Në departamentin e geriatriës akomodohen pacientë mbi 65 vjeç, por ka edhe pacientë më të rinj. Tualeti në repart është në gjendje katastrofike dhe higjiena në pjesën tjetër të repartit ishte e kënaqshme. Ka një dhomë të veçantë mense. Në këtë pavion u informuam se një pacient 70-vjeçar i transferuar nga repartit i dytë i meshkujve, sipas gjendjes shëndetësore, mund të jetojë në kushte jashtë spitalore, pasi është një person me personalitet. çrregullim, pra një “psikopat”, sipas tyre, i cili ngacmonte dhe ngacmonte seksualisht një pacient të çmendur të vendosur në të njëjtin pavion. Ky veprim nuk është raportuar tek institucionet kompetente nga stafi. Stafi e përballon këtë sfidë duke e mbyllur njërin prej tyre në dhomë, pra kur pacienti është jashtë dhomës, pacienti mbyllet në dhomë dhe anasjelltas, që është sjellje e papërshtatshme në këtë seksion.

Pacientët kronikë janë të vendosur në repartin e katërt dhe të pestë të meshkujve. Në këto dy departamente, stafi përballet me 2 kategori pacientësh me të cilët kanë probleme, pra me pacientë që nuk pranohen nga familjet dhe mund të jetojnë me mbështetje dhe me raste sociale, të pastrehë që nuk kanë ku të shkojnë nëse dilni jashtë dhe askush të mos kujdeset për ta. Dhe në këto reparte tualeti është në gjendje të keqe. Akomodojnë 6-8 pacientë në një dhomë, dhe kushtet materiale në këto anë janë të këqija, pra të vjetra. Një pjesë e këtyre pacientëve janë të punësuar në mirëmbajtjen e higjienës dhe pastrimin, për çka marrin 300 denarë në muaj, me të cilat punonjësi social u siguron gjërat e nevojshme si cigare, ushqim, lëngje e të ngjashme.

Reparti i tretë i grave ishte duke u rinovuar gjatë vizitës, por pacientet e vendosura në të nuk u zhvendosën në një pavijon tjetër. Nga ana ku nuk ndodhen dhomat ishin nxjerrë dritaret dhe dhomat ishin të ftohta. Gjithashtu, tualetet ishin duke u rinovuar në këtë objekt dhe nuk ishin funksionale gjatë vizitës, kështu që pacientët përdornin tualetin e një departamenti tjetër ose liheshin vetë për të kuptuar se ku të shkonin në tualet.

Në repartin/departamentin e gjykatës nuk ka asnjë siguri shtesë. Personat që ata i konsiderojnë problematikë (disa prej tyre ishin edhe në videot e publikuara këtë vit dhe që u sollën dhunshëm) strehohen veçmas nga pjesa tjetër e pacientëve të departamentit të gjykatës në një ambient tjetër dhe ka siguri shtesë të punësuar nga spitali. Duhet theksuar se kushtet materiale në këtë pjesë të objektit (objektit të rinovuar) ku janë vendosur këta persona janë të mira dhe të kënaqshme, për dallim nga kushtet materiale të pacientëve të tjerë nga departamenti i gjykatës. Kushtet në seksionin e gjykatës ishin të këqija, ndërtesa është e vjetër, ka lagështi dhe rrëshqitje, dhe ambientet ishin të ftohta. Batanijet, çarçafët dhe shtretërit ishin të vjetra. Higjiena dhe gjendja në tualet ishte shumë e dobët dhe nuk plotëson as standardet bazë dhe as ato ndërkombëtare. Këta pacientë në seksionin e veçantë na informuan se dalin për shëtitje kur dhe sa të duan. Në pjesën e departamentit të gjykatës, ku ndodhen shumica e pacientëve, zona e ecjes është e rrethuar dhe shumë e vogël. Pacientët nga reparti i gjykatës u ankuan për komunikim të parregullt me familjet e tyre, duke pasur parasysh se nuk kanë telefon dhe foltore në dispozicion dhe varen nga punonjësi social, i cili sipas deklaratave të tyre nuk vjen shumë shpesh dhe kur vjen në repart, ai u lejon atyre të komunikojnë me telefon. Gjithashtu, pacientët janë ankuar se lavatriçeja është e prishur dhe nuk

funksionon dhe të gjitha rrobat i lajnë me dorë. Sa i përket pacientëve nga departamenti i gjykatës të cilët janë të ndarë, duhet theksuar se gjatë vizitës derën e objektit na e kanë hapur vetë pacientët dhe sigurimi është paraqitur më vonë.

**Bujtina** strehon pacientë që mund të kujdesen për veten e tyre dhe të cilët mbeten vetëm për pjesën më të madhe të ditës. Ata gatujnë dhe ruajnë higjienën e tyre dhe pasdite mbeten krejtësisht vetëm. Gjendja e tualetit ishte e keqe. Kushtet e tjera ishin të kënaqshme.

Pacientët e **repartit të 3-të të meshkujve, i alkoolit dhe i brendshëm** janë të vendosur në dhoma krejtësisht të reja dhe kushtet janë mjaft të kënaqshme. Të gjitha pajisjet janë të reja dhe këta pacientë jetojnë në kushte shumë më të mira në krahasim me të tjerët.

Për sa i përket dokumentacionit mjekësor, në dosjen e një pacienteje me dëmtim në krah që ka marrë në spital, nuk shënohet se si e ka marrë dëmtimin, në dosje ka pasur vetëm raporte specialistike për dëmtimin.

Sa i përket barnave, në spital nuk disponohen të gjitha barnat e nevojshme, veçanërisht medikamentet e reja dhe preparatet depo që aplikohen çdo muaj, duke parandaluar kështu rikthimin e sëmundjes në rast të pirjes së parregullt të barnave të përshkruara nga mjeku psikiatër. Të njëjtat barna ishin të disponueshme vetëm në Klinikën Psikiatrike, duke bërë diskriminim ndaj pacientëve të trajtuar në Spitalin Psikiatrik të Shkupit. Disponueshmëria e këtyre barnave mund të parandalojë rikthimet dhe përkeqësimin e sëmundjes në rast të ndërprerjes së ilaçeve nga vetë pacientët, gjë që do të sigurojë funksionim më të mirë të pacientëve në komunitet, pra jashtë spitaleve psikiatrike, duke parandaluar kështu mbipopullimin e spitaleve, mbajtjen e tyre. e pacientëve për dekada në spitale dhe zhvillimi i spitalit midis pacientëve.

ECT-ja, as ajo native dhe as me anestezi, prej vitesh nuk përdoret në spital. Pacientët nuk kanë informacion për të drejtat e tyre dhe aksesin në ndihmë juridike.

Autopsitë e pacientëve që kanë vdekur në spital zakonisht nuk bëhen, sepse familjet nuk i duan, përveç nëse vdekja ndodh brenda 24 orëve të para të shtrimit në spital. Kemi marrë edhe shpjegimin se shpenzimet e autopsisë i bartë spitali, prandaj stafi zakonisht nuk insiston për kryerjen e autopsisë.

## → **Rekomandime:**

### Konstatimet fillestare:

- Është e nevojshme që shteti, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, të krijojnë kapacitete për zbatimin e reformave në psikiatri, dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shëndetin Mendor, duke larguar pacientët që nuk kanë nevojë për trajtim spitalor nga spitalet mendore dhe duke i vendosur ato në komunitet, ku do të jetë i mundur trajtimi dhe kujdesi i vazhdueshëm për pacientët pas daljes nga spitali.
- Është e nevojshme që spitali dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të zbatojnë psikoedukimin e familjeve dhe kujdestarëve të pacientëve, lidhur me kthimin e pacientëve në familje dhe komunitet dhe vazhdimin e trajtimit dhe kujdesit për pacientët pas daljes nga spitali.

### Trajtimi keq:

- Është e nevojshme që spitali të zbatojë edukim të përshtatur për pacientët, i cili do të jetë i lidhur me dhunën.

### Kushtet e jetesës:

- Është e nevojshme që shteti të sigurojë masat dhe burimet e nevojshme financiare për rinovimin e ambienteve të spitalit, të cilat janë të vjetra, me lagështirë dhe dragua, nuk kanë dyer ndërmjet dhomave dhe korridoreve, si dhe rinovimin e ambienteve të tualeteve për të mundësuar kushte më të mira materiale në spital. Financimi nevojitet gjithashtu për zëvendësimin e vazhdueshëm të batanijeve, çarçafëve, veshjeve, shtretërve, dyshekëve, dollapëve, lavatriçeve dhe enëve dhe pajisjeve të tjera të vjetra.
- Është e nevojshme të sigurohen ambiente në spital për të akomoduar maksimumi 4 pacientë në një dhomë.
- Është e nevojshme që spitali të ofrojë ushtrime në natyrë me pacientët dhe që të gjithë pacientët të ekspozohen ndaj ajrit dhe dritës së ditës.



- Është e nevojshme të ruhet temperatura në dhomat e spitalit dhe dhomat e tjera jo më të ulëta se 18 gradë Celsius.
- Është e nevojshme të caktohet një dhomë për pirjen e duhanit për pacientët, në mënyrë që ata të mos pinë duhan në të gjitha ambientet dhe dhomat e gjumit.

## Stafi:

- Shteti duhet të marrë masa për të shtuar ekipin e psikiatërve, infermierëve, psikologëve, punonjësve socialë dhe personelit tjetër në spital.
- Spitali duhet të bëjë një plan trajnimi dhe të zbatojë trajnime për stafin, duke përfshirë trajnimin për:
  - trajtimin e dhunës ndërmjet pacientëve dhe stafit,
  - pacientët vullnetarë/të pavullnetshëm dhe kalimi nga pacientë vullnetarë në pacientë të pavullnetshëm, gjë që do të parandalojë privimin e lirisë së pacientëve për dekada dhe zhvillimin e shtrimit në spital,
  - aplikimi i mjeteve të kufizimit dhe izolimit.
- Është e nevojshme që spitali të krijojë protokolle për parandalimin e vetëlëndimit dhe vetëvrasjes, si dhe protokolle për trajtimin e dhunës ndaj personave të tjerë (heteroagresion).

## Trajtimi:

- Shteti, gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, të sigurojnë mjete financiare për të siguruar disponueshmërinë dhe aksesin e të gjitha barnave të nevojshme për trajtimin e të sëmurëve mendorë, veçanërisht barnat e reja dhe preparatet-depo që aplikohen çdo muaj, me qëllim parandalimin e rikthimit të sëmundjes gjatë pirjes së parregullt të barnave nga pacientët. Kjo do të sigurojë funksionim më të mirë të pacientëve në komunitet, pra jashtë spitaleve psikiatrike dhe do të parandalojë

mbipopullimin e spitaleve, mbajtjen e pacientëve për dekada në spitale dhe zhvillimin e sindromës së hospitalizimit.

- Të ofrohet trajtim psiko-social në çdo departament dhe të motivohen pacientët për një trajtim të tillë.

## Mjetet e kufizimit dhe izolimit:

- Është e nevojshme që spitali të ofrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe dhoma të ndara me një pasqyrë të veçantë për monitorimin e pacientit, përmes së cilës pacienti mund të shohë personelin që ndodhet këtu, në të gjitha repartet ku zbatohen kufizimet dhe izolimi, si dhe zbatimin e këtyre masave, që të mos ndodh para pacientëve të tjerë. Pacientët ndaj të cilëve zbatohen këto masa duhet të kenë akses në tualet dhe në fund të izolimit, personeli mjekësor duhet të bisedojë me pacientin.
- Është e nevojshme futja e regjistrave për përdorimin e mjeteve të kufizimit dhe izolimit.

## Masat mbrojtëse/statusi ligjor i pacientëve:

- Nevojitet që spitali të rishikojë statusin ligjor të të gjithë pacientëve "vullnetarë" të shtruar në spital, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i nevojës për t'iu drejtuar procedurës së vendosjes së pavullnetshme të atyre që nuk dëshirojnë ose për shkak të gjendjes së tyre mendore, konsiderohen të mos kenë mundësinë për të dhënë pëlqimin; si dhe për të gjithë pacientët e paaftë dhe ata që për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mund të lejohen të largohen nga spitali, pavarësisht nëse shtrohen vullnetarisht, duke i lejuar në këtë mënyrë të përfitojnë nga masat mbrojtëse të parashikuara nga ligji për pacientët e ndaluar pa vullnetin e tyre.
- Është e nevojshme që shteti të ofrojë mekanizma dhe masa për parandalimin e keqpërdorimit të Ligjit për dhunën në familje dhe masave të VPP-së, si dhe masat e sigurisë për mbajtje të detyruar dhe trajtim në spital psikiatrik (rastet gjyqësore).

## Çështje të tjera:

- Kërkohet sigurimi i aksesit të rregullt dhe më të shpeshtë telefonik për pacientët.
- Është e nevojshme të vendoset një kabinë telefonike në departamentin e gjykatës.
- Kërkohet trajnim për sigurinë private lidhur me punën me këto kategori pacientësh.
- Një autopsi kërkohet sa herë që një pacient vdes në një spital psikiatrik, përveç nëse vendoset një diagnozë e qartë fatale para vdekjes.
- Është e nevojshme që spitali të informojë pacientët dhe të nxjerrë në pah informacionin në vende të dukshme për të drejtat e pacientëve, si dhe të sigurojë akses në ndihmë juridike.
- Është e nevojshme të krijohet një praktikë që drejtori i spitalit të marrë ankesa nga pacientët.
- Është e nevojshme të parandalohet abuzimi seksual dhe ngacmimi i pacientëve, por nëse kjo ndodh të raportohet në institucionet kompetente.
- Është e nevojshme të regjistrohen të gjitha dëmtimet e pacientit që ndodhin në spital në kartelat mjekësore dhe në një regjistër të veçantë.
- Është i nevojshëm rishikimi i masave të sigurisë për personat e vendosur në repartin/departamentin e gjykatës.

**Tabela 1.**  
**Shpërndarja e pacientëve sipas reparteve në Spitalin Psikiatrik “Shkup”**

Reparti/ departamenti	Shtretër	Gjithsej pacientë të sëmurë në r epart			Të liruar me kusht			Të sëmurë në repart			Me vendim gjyqate		
		M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
Akut	22	13	9	22				13	9	22	3		3
Idyti i meshkujve	46	57		57	15		15	42		42	12		12
Intern	23	17	4	21				17	4	21	3		3
Idyti i grave	14		16	16		3	3		13	13		3	3
I Alkoolizmit	32	15	2	17	3		3	12	2	14	7		7
Gjithsej	137	102	31	133	18	3	21	84	28	112	25	3	28
I tretii meshkujve	24	27		27		2	2	25		25	4		4
I tretii i grave	50		35	35					35	35			
I katërti i meshkujve	21	33		33				33		33	3		3
I pesti i meshkujve	13	11		11				11		11	1		1
I Gjykatës	40	41		41				41		41	41		41
Hosteli	14	8	6	14				8	6	14	2		2
Geriatra	24	14	10	24				14	10	24	4		4
Gjithsej	186	131	55	186		2	2	131	54	185	55		55

## ISHP SPITALI PSIKIATRIK NEGORCI

Vizita në ISHP Spitalin Psikiatrik Negorci filloi me një bisedë me drejtorin e institucionit. Gjatë vizitës, në spital janë akomoduar 231 pacientë, me kapacitet 220 + 15 shtretër shtesë falas. Spitali ka gjithsej 9 departamente. Në departamentin e gjykatës ka vetëm burra. Disa nga personat me VPP janë vendosur në departamente të tjera të spitalit. Gratë janë të vendosura në pavijonet e grave të spitalit me vendim gjykate, duke qenë se nuk ka një repart të veçantë gjyqësor për gratë. Në spital pranohen pacientë mbi 18 vjeç.

**Tabela 2.**  
**Shpërndarja e pacientëve sipas reparteve në Spitalin Psikiatrik Negorci**

<b>Reparti/departamenti</b>	<b>Pacientë me masa edukative -korrektuese</b>	<b>Pacientë penalë</b>	<b>Gjithsej pacientë</b>
<b>A - kronik-gjysëm gjykatës</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>22</b>
<b>B - repart i gjykatës</b>	<b>28</b>	<b>3</b>	<b>37</b>
<b>C1 - prikogeria e grave</b>	<b>/</b>	<b>1</b>	<b>21</b>
<b>C2 - alkoolizmit</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>33</b>
<b>D - psikogeria e meshkujve</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>41</b>
<b>F1 - akut-meshkuj</b>	<b>3</b>	<b>/</b>	<b>15</b>
<b>F2 - akut-gra</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>14</b>
<b>G1 - akut-meshkuj</b>	<b>2</b>	<b>/</b>	<b>24</b>
<b>G2 - kronik-gra</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>24</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>54</b>	<b>20</b>	<b>231</b>

Në bashkëbisedimin me përfaqësuesit e spitalit, kuptuam se ka problem në menaxhimin e pacientëve si pacientë të ndaluar vullnetarisht dhe në mënyrë të pavullnetshme. Pothuajse të gjithë pacientët, edhe pse të ndaluar në mënyrë të pavullnetshme, menaxhohen si të ndaluar vullnetarisht. Nëse pacienti pranon të nënshkruajë për shtrimin vullnetar brenda 24-48 orëve, ai trajtohet si vullnetar, edhe pse është sjellë me forcë; në të kundërtën njoftohet gjykata dhe për 24-48 orë vjen në spital një

gjyqtar nga Gjevgjelia. Nga stafi merret informacion se ka një numër të madh pacientësh që qëndrojnë në spital për më shumë se 1 vit, por ka edhe nga ata që qëndrojnë shumë më tepër se një vit. Numri i pacientëve apsikotikë për të cilët nuk ka indikacione për trajtim spitalor dhe që janë ende në spital pasi nuk ka kush t'i marrë është rreth 80, gjë që e vështirëson realisht punën e spitalit. Disa prej tyre raportohet se janë në gjendje stabile, por duke qenë se askush nuk dëshiron t'i marrë, ata qëndrojnë në spital, ndonëse mes tyre ka persona të cilëve u është caktuar kujdestar, pa e ndryshuar masën e paraburgimit në të pavullnetshëm dhe të njoftohet gjykata, pra pa përfituar nga masat mbrojtëse të parashikuara në ligj për pacientët e ndaluar në mënyrë të pavullnetshme, gjë që, në fakt, i heq lirinë. Ata nuk kanë praktikë për ndryshimin vullnetar në jo vullnetar, në përgjithësi i trajtojnë të gjithë pacientët si vullnetarë. Arsyeja për këtë, siç na theksuan, është se ata nuk duan t'i lënë ata pacientë pa mbikëqyrje për shkak të gjendjes së tyre, prandaj është mënyra më e thjeshtë. Në pyetjen tonë se çfarë ndodh nëse raste të tilla kërkojnë të largohen dhe janë këmbëngulës në kërkesën e tyre, na u tha se nëse gjykojnë se gjendja e tyre shëndetësore është mjaft e mirë për të funksionuar vetë jashtë, i lënë të shkojnë duke u dhënë terapinë e duhur që duhet të marrin jashtë. Kur ndodh paraburgimi i detyruar, pas njoftimit të gjykatës, gjyqtarët nga gjykata e Gjevgjelisë vijnë për të inspektuar, që është praktikë e mirë.

Pacientët e shqetësuar që mund të dëmtojnë veten ose të tjerët fiksohen deri në dy orë, në dhoma të veçanta me kufizime magnetike dhe me xham antiplumb dhe izolim përmes të cilit mund të shihni në dy drejtime, në mënyrë që pacienti të mund të shohë stafin gjatë gjithë kohës, dhe në të njëjtën dhomë me pacientin është fizikisht i pranishëm edhe një person tjetër nga stafi. Pasi personi qetësohet, ai kalon pak kohë në një dhomë tjetër ende nën mbikëqyrje, megjithëse nuk është më i fiksuar me kapëse, bisedohet me të dhe më pas kthehet në repart. Ata kanë dy dhoma të tilla në spital, njëra prej të cilave është dhomë burrash dhe tjetra dhomë e grave. Mbahet një procesverbal i veçantë për fiksimin - i nënshkruar nga mjekët që monitorojnë situatën. Dhomat janë të izoluara me sfungjer dhe lëkurë artificiale dhe janë të ndara nga dhomat e akomodimit të repartit. Ata kanë dhoma të veçanta në të gjitha departamentet, me nga një krevat brenda.

Për sa i përket personelit, spitali ka: 4 mjekë specialistë psikiatër, 2 që po specializohen, 2 mjekë të mjekësisë së përgjithshme, 28 infermierë, 12 mjekë ndihmës + 15 mjekë ndihmës, 1 punonjës social, 2 psikolog, 1

higjienist, 9 persona që punojnë në kuzhinë ( 3 kuzhinierë, 3 ndihmëskuzhinierë, 3 shërbyese), 1 jurist, 1 arkiviste, 2 ekonomistë. Është e qartë se numri i mjekëve psikiatër në spital është shumë i ulët, sidomos duke pasur parasysh numrin e madh të pacientëve, por si problem u theksua edhe mungesa e infermierëve dhe ndihmësve. Orari i punës është nga 7:45 deri në 14:45; psikiatër gjatë kujdestrisë janë në detyrë çdo të katërtën ditë, pas së cilës janë të lirë për 24 orë. Infermieret punojnë në 3 turne, të parën, të dytën dhe të tretën dhe më pas kanë 2 ditë pushim. Stafi gjatë kujdestarisë - turni i dytë dhe i tretë - përbëhet nga 1 mjek psikiatër, 5 infermiere, 3 infermierë dhe 2 mjekë ndihmës.

Nuk ka protokolle për pacientët vetëvrasës dhe regjistra fiksimi, por të dhënat për pacientët e fiksuar dokumentohen në një fletore.

Gjatë pranimit, pacientët rruhen, qethen, lahen dhe vishen me rroba të pastra dhe u merren sendet me vlerë, edhe pse kanë dollapë që mund të mbyllen. Spitali ka një gardërobë për të gjitha stinët, të cilën e mbajnë në dhoma të veçanta dhe e përdorin për pacientët. Pothuajse të gjithë pacientët janë me rroba të përditshme, nuk kemi vërejtur pacientë me pizhame, as me rroba të grisura apo të dëmtuara.

Ata theksuan se gjatë një pranimi të ri, gjithmonë kontrollojnë nëse pacientit i është hequr aftësia afariste, qoftë nga personat që e bartin atë ose më vonë kërkojnë informacion nga qendrat për punë sociale. Gjithashtu evidentohet nëse kanë kujdestar. U theksua se për pacientët që kanë kujdestar, Qendra për punë sociale nuk tregon interes dhe nuk ndërmer masa për t'i nxjerrë nga spitali. Ata i vizitojnë vetëm ndonjëherë. Ata na theksuan se nuk pranojnë pacientë vetëm nga rajoni, por kanë pacientë nga Tetova dhe Shkupi, sidomos për shkak të kushteve më të mira. Megjithatë, u theksua se ka raste të keqpërdorimit të masave të VPP-së për mbrojtje nga dhuna, me shembull një pacient të palëvizshëm i cili është 70 vjeç dhe i raportuar se ka kryer dhunë në familje. Stafi raporton se kanë vështirësi në thyerjen e masave dhe janë nën presion për të mbajtur pacientët, edhe nën kërcënimin e një urdhri për dhunë në familje. Ata vuajnë edhe nga kërcënimet e kujdestarëve të pacientëve, të cilët nuk duan t'i çojnë pacientët në shtëpi dhe kërcënojnë se do të telefonojnë gazetarët dhe televizionet, etj.

Pacientët lahen 2 herë në javë, një nga një individualisht dhe ata që duan ose kanë nevojë, lahen disa herë në javë. Ka ujë të ngrohtë në banjo. Dy herë në javë ata mund të përdorin telefonin për 2 orë, por nëse është e

nevojshme, të afërmit e tyre mund të telefonojnë më shpesh telefonin e zyrës. Ata theksuan se vetë mjekët kanë komunikim me familjet, janë në dispozicion të tyre në mënyrë individuale.

Në spital ka një lavanderi, në të cilën janë dy punonjës dhe ndihmojnë 2 pacientë. Pacientët që merren me punë, në lavanteri, por edhe për gjëra të tjera, si p.sh. në kuzhinë, marrin 1500 denarë në muaj.

Në spital ka dhunë ndërmjet pacientëve, por shumë rrallë. Na u dha një shembull i një rasti që është raportuar në polici dhe personi ishte ekzaminuar. Rrallëherë ka ndodhur që një nga stafi të sulmohet, por nuk është raportuar në stacion policor.

